

URDHËR
Nr. 15, datë 11.1.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e disa kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, si më poshtë:

a) Autorizimet e inspektimeve dhe shkresat njoftuese të institucioneve për këto inspektime, në rastin kur janë të njëjta me planin mujor të miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, do të nënshkruhen nga drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve.

b) Dërgimi i kopjeve të procesverbaleve të marrjes në dorëzim dhe të inventarëve, pas përfundimit të procesit të dorëzimit do të nënshkruhen nga drejtori i Arkivave Shtetërore Vendore.

c) Autorizimet për marrjen në dorëzim në arkivin përkatës do të nënshkruhen nga drejtori i Arkivave Shtetërore Vendore ose drejtori i Arkivit Qendror Shtetëror, sipas fushës së përgjegjësisë.

2. Kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen deri në një urdhër të dytë.

3. Në rast të mungesës së personit të përcaktuar në këtë urdhër, kompetencat do të ushtrohen vetëm nga drejtori i përgjithshëm.

4. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve dhe drejtori i Arkivave Shtetërore Vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido